



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1317/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike sh.a (Kesco), me seli në Prishtinë, rr. “Bill Klinton” nr.5, ndaj debitorit DPH– N.H. rr. – Pejë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Valon Kastrati nga Peja, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, Ep.nr.717/2019 të datës 03.11.2020, jashtë seancës me datë 09.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit DPH– N.H. rr. – Pejë, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, Ep.nr.717/2019 të datës 03.11.2020 dhe Lënda i kthehet Dhomës së shkallës së parë të Gjykatës Komerciale-Departamenti për çështje ekonomike, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktvendimin e atakuar, Ep.nr.717/2019 të datës 03.11.2020, ka vendosur si në vijim: “ Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit– N.H., rr. “....”, i parashtruar kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat Jeton Krasniqi në Pejë, P.nr.942/18 i dt. 27.11.2018.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP –së, LMD dhe LPK – së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet në tërësi ankesa e debitorit, të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të refuzohet në tërësi propozimi

për përmbarrim për shkak të parashkrimit të kërkesave në kuptim të nenit 360 të LMD –së dhe shkeljeve të neneve 71.1.4 të LMD –së, lidhur me nenin 37,38 të LPP –së lidhur me nenin 102 dhe 182 (n) të LPK –së, ashtu që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktvendimi i kundërshtuar, të refuzohet në tërsi propozimi për përmbarrim për shkak të parashkrimit të kërkesave ashtu që të anulohet-shfuqizohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.942/18 dt. 03.11.2020, në kuptim të nenit 43.4 të LPP –së, ose aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i kundërshtuar ashtu që çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me dt. 26.11.2018, pranë gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstraktit nga librat afarist me nr. DPE – të dt. 29.12.2018, për shumën e borxhit në vlerë prej 1.373.04 euro.

Përmbarruesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me urdhrin P.nr. 942/18 të dt. 27.11.2018, ka lejuar përmbarrimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm – Ekstrakti nga librat afarist me nr. DPE – të dt. 29.12.2018, i plotëson kushtet për përmbarrim.

Ndaj këtij urdhri, me datë 10.12.2018, debitori ka paraqitur prapsim, me propozim për gjykatën që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar, të refuzohet në tërësi propozimi për përmbarrim i kreditorit si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarrimor P.nr. 942/18 të dt. 27.11.2018, në kuptim të nenit 43.4 të LPP –së. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar që prapësimi i debitorit është i pa argumentuar andaj ka propozuar që urdhri të mbetet në fuqi dhe nëse gjykata edhe pas përgjigjes në prapësim nga kreditori nuk është qartësuar lidhur me validitetin e përgjigjes së kreditorit në kuptim të nenit 73 të LPP –së, të hap seancë publike.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin të debitorit, dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, me aktvendimin e atakuar, Ep.nr.717/2019 të datës 03.11.2020, ka refuzuar prapësimin e debitorit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se prapësimi nuk përmban asnjë nga shkaqet e përcaktuara me nenin 71 të LPP –së, në bazë të cilave shkaqe gjykata duhet ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Pretendimet e debitorit në prapësim se në rastin konkret ka kaluar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbarimi, duke theksuar se borxhi i kërkuar sipas dokumentit të besueshëm është i parashkruar, gjykata i refuzoj si të pa bazuara, për faktin se debitori ka bërë pagesë të kohë pas kohshme të borxhit të cilat kanë ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit dhe rrjedhimisht edhe pranimin e borxhit nga ana e debitorit. Andaj, gjykata nuk i ka pranuar pretendimet e debitorit që gjykata është dashur ti zbatoj dispozitat e nenit 360 par 1 pika 1.1 dhe 2 të LMD –së, për arsye se në rastin konkret me pagesat e bëra nga debitori dhe të fundit me dt. 01.11.2018 ka ardhur deri tek ndërprerja e parashkrimit ngase propozimi i kreditorit për përmbarim është parashtruar me dt. 26.11.2018, pa kaluar afati 1 vjeçar i përcaktuar me nenin 360 të LMD –së, nga koha e fillimit të afatit të ri të parashkrimit, dhe atë duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 368 dhe 373 par 6 të LMD –së. Meqenëse debitori nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilin vërtetohet se është përmbushur detyrimi sipas dokumentit të besueshëm bazë të së cilit kërkohet borxhi në shumë prej 1.373.04, gjykata duke ju referuar nenit 69 par 4 të LPP –së, vendosi të refuzoj prapësimin.

Vlerësimin juridik të gjykatës se shkallës së parë, kjo gjykatë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave nga neni 182.2 paragrafi n) të LPK-së, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe rrjedhimisht zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 360, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 368 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së.

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n) e lidhur me nenin 160 dhe 175 të LPK-së, sepse dispozitivi i aktvendimit është në kundërtënie me arsyet e aktvendimit dhe për faktet vendimtare, aktvendimi nuk përmban arsye për mënyrën e vendosjes. Gjykata ka dështuar të jep arsye për pretendimet e palës ankuese të paraqitura në prapësim lidhur me parashkrimin e kërkesës. Gjykata për pretendimin e parashkrimit ka dhënë një shpjegim të përgjithshëm pa u lëshuar në arsye konkret se pse gjykata ka vlerësuar se duhet të zbatohen dispozitat e nenit 360 paragrafi 1, pika 1.1 dhe paragrafi 2 si dhe neni 368 paragrafi të LMD-së. Përveç kësaj gjykata do të duhet të vlerësonte secilën faturë të arritur për pagesë dhe rrjedhimisht parashkrimin sipas secilës faturë të arritur për pagesë.

Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe në harmoni me dispozitat ligjore.

Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se: “Organi përmbaues e cakton, e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbaues (titulus exexecutionis) dhe dokumentit të besueshëm po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Në kuptim të kësaj depozitë nënkuptojmë se organi përmbaues-gjykata, duhet të vendos brenda kufijve të titullit përmbaues ndërsa me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit është dashur të vlerësoj se a ekziston ndonjëri nga shkaqet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP-së,

Përveç tjerash sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, gjykata e shkallës së parë me vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të fakteve të çështjes, ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat ligjore të LPP-së, për arsye se në këtë rast gjykata e shkallës së I-rë, nëse do të kishte dilema lidhur me parashkrimin për periudhën kohore të pretenduar si në kundërshtim, ka pasur mundësi që me qëllim që të eliminoj këto dilema në kuptim të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së, të cakton seancën dëgjimore në të cilën përmes deklaratimit të palëve do të mund të eliminonte këto paqartësi, që pastaj gjykata të kishte mundësi që të vendoste për ligjshmërinë e aktvendimit për lejimin e përmbarimit.

Përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për ndërprerjen e parashkrimit tani për tani nuk mund të pranohet si përfundim i drejtë dhe i ligjshëm nga gjykata ankimore, për shkak se me nenin 368 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se: “ *Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin*”, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: “ *Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit*”.

Në kontekstin e këtyre dispozitave arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë se në këtë rast kemi pohim të borxhit nga ana e debitorit për shkak të pagesës së kohëpaskohshme sipas vlerësimit të gjykatës ankimore nuk është i themeltë, për shkak se në këtë rast nuk bëhet fjalë për dhënien e kësteve ngase pagesat e kohëpaskohshme të debitorit nuk mund të konsiderohen si këste. Ato pagesa janë të papërcaktuara në shumat që dallojnë njëra nga tjetra dhe nuk lënë të kuptohet se për cilën periudhë debitori ka paguar borxhin, po ashtu në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka ekzistuar ndonjë marrëveshje që borxhi të paguhet me këste ose së paku në shkresa të lëndës nuk kemi një dëshmi të tillë.

Të gjeturat dhe konstatimet e bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e atakuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka si i tillë u dashtë që të prishet dhe lënda ti kthehet dhomës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Për më tepër, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike për nevojat shtëpiake, të cilat konform nenit 360 të LMD –së,

parashkruhen në afat një vjeçare, por kemi të bëjmë me raport komercial, pra kemi kreditorin si operator i cili ofron shërbime publike dhe debitorin si person juridik, nga rrjedhë që gjykata gabimisht parashkrimin e ka vlerësuar në kuptim me nenin 360 të LMD-së, pra e njëjta është dashur që institutin e parashkrimit ta vlerësoj në raport me nenin 355 të LMD –së, i cili përcakton se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë në kuptim të të gjeturave dhe konstatimeve të bëra si më lartë nga Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e shkallës së dytë, udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, ashtu që të shqyrtoj prapësimin duke vlerësuar se a janë plotësuar kushtet për lejimin e përmbartimit. Në rast se vlerëson se nuk janë plotësuar prezumimet procedurale për lejimin e përmbartimit, atëherë të veprojë në pajtim me dispozita e nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, dhe pastaj nëse nuk eviton të meta të veprj në pajtim me dispozita për vendosjen sipas prapësimin kur prapësimi është i bazuar, përkatësisht nëse ekzistojnë shkaqet e prapësimin duke mos përjashtuar edhe mundësinë e dëgjimit të palëve dhe varësisht nga të gjeturat edhe të vendos në këtë çështje përmbartimore, që pastaj përmes vërtetimit të drejtë të fakteve duke aplikuar dhe zbatuar dispozitat të së drejtës materiale, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj çështjen e parashkrimit të kërkesës së kreditorit sipas prapësimin të bërë nga debitori, të vërtetojë faktin e arritjes së secilës kërkesë sipas dorëzimit të faturave dhe varësisht nga pranimi i secilës faturë të llogarisë edhe afatin e parashkrimit të kërkesës, duke sjellë një vendim të drejtë i cili do të ketë mbështetje të plotë në shkresat lëndore dhe në ligj, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitoj shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160, e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Kompetenca e Dhomës së dytë të Gjykatës Komerciale për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1317/22 me datë 09.09.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha

